



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 85/25

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 03.02.2025

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

<b>DATE/A</b>	03.02.2025
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH</b>	Kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Drejtori i DBZHR-së z. Ergin Sungur
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>THIRRJE PER APLIKIM</b>

Për fermerët e Komunës së Vushtrrisë për përfitim në kuadër të implementimit të projektit: " Subvencionimi i prodhimit të qumështit".

### I. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është njoftimi i të gjithë fermerëve – blegtorëve prodhues të qumështit, të Komunës së Vushtrrisë se Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në kuadër të Programit për Zhvillimin e Bujqësisë do të subvencionojë prodhimtarinë e qumështit për periudhën janar –qershor 2024.

### II. Mënyra e subvencionimit.

- Subvencionimi do të bëhet për litër të qumështit të dorëzuar në pikë grumbulluese ose në fabrika të përpunimit të qumështit në vlerë prej 0.05€/litër;
- Përfitues do të jenë fermerët prodhues të qumështit sipas standardeve të legjislacionit në fuqi.

### III. Kriteret e përcaktuara

- Aplikuesi duhet të jetë banorë i Komunës së Vushtrrisë.



- Të dorëzoj më shumë se 2000 litra qumësht për këtë periudhë 6 muajore.
- Të posedoj kontratë, të vërtetuar nga noteri, për shitjen e qumështit në ndonjërin nga qumështoret e licencuara ose me ndonjërin nga pikat grumbulluese të qumështit të regjistruara si biznes dhe që kanë kontratë me ndonjë nga qumështoret e licencuara;
- Të ofroj dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërin nga qumështoret e licencuara;
- Të ofroj dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar).

#### **IV. Dokumentacioni i nevojshëm:**

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Konfirmimin nga banka për posedim të llogarisë bankare aktive;
3. Vërtetimin nga pika grumbulluese ose qumështorja për sasinë e qumështit të dorëzuar për periudhën Janar – Qershor 2024;
4. Kopja e listës së verifikimit të kafshëve të lëshuar nga sektori për identifikim dhe regjistrin në kuadër të AUV;
5. Dëshmia e pagesës nga banka për sasinë e qumështit të shitur (dorëzuar)- pasqyra bankare;
6. Kopja e kontratës, e vërtetuar nga noteri, për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara ose pikat grumbulluese të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjë qumështore të licencuar.

Kjo thirrje publike është e hapur për aplikim prej datës: **03.02.2025 – 21.02.2025.**

Aplikacioni dorëzohet në zyrën e pranimit çdo ditë pune.

